



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 62, Datë 22.09.2020

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	SHA UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP 3 (tre procedura) • Reklamim nga të tretë 1 (një procedurë)
Numri i procedurave të verifikuara	4 (katër)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë “E hapur”: 3 (tre) “Kërkesë për propozim”: 1 (një)
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me përllogaritjen e fondit limit në tre procedura prokurimi të verifikuara. 2. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk vijnë në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, në tre procedura prokurimi të verifikuara. 3. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në lidhje me vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, në tre procedura prokurimi të verifikuara. 4. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

	publik”, i ndryshuar, sa i takon shqyrtimit të ankesave/kërkesave për sqarim dhe shtyrjes së afatit të pritjes së ofertave në një procedurë prokurimi të verifikuar.
Masat e marra	Në bazë të neneve 13, pika 2/i, 72, pikat 1/dh/gj/i dhe 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi të dënojë me gjobë 15 (pesëmbëdhjetë) persona të evidentuar përgjegjës, për mospërmbyllje të detyrimeve të përcaktuar në nenet 28, 46 dhe 53 të këtij ligji, si dhe t’i propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktor, marrjen e masës disiplinore ndaj 2 (dy) personave, të evidentuar përgjegjës për shkelje dhe mangësi të konstatuara në vendim.